



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 6141 Prot

Lezhë, më 20 / 04 /2022

VENDIM

Nr. 40, Datë 19. 04.2022

Për një ndryshim në V.K.Bashkiak nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024” dhe përdorim të fondit të kontigjencës

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e këtyre ndryshimeve në buxhetin e vitit 2022, si më poshtë:

a. Pakësohen fondet në :

a.1- Programin buxhetor ‘05100’ “Menaxhimi i Mbetjeve” për objektin “Blerje dy dum-duma për pastrim mbetjesh” në shumën 1,000,000 lekë.

a.2- Programin buxhetor ‘04240’ “Ujitja dhe Kullimi” për objektin “Blerje eskavatori me krah 12 ml” në shumën 6,000,000 lekë.

b. Shtohen fondet në :

b.1- Programin buxhetor ‘03280’ “Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi” për objektin “Blerje automjeti për MZSH” në shumën 2,448,000 lekë.

b.2- Programin buxhetor ‘04240’ “Ujitja e Kullimi” shtesë fondi për objektin “Blerje automjeti për Njësinë e Ujitjes dhe Kullimit” në shumën 1,248,000 lekë.

b.3- Programin buxhetor ‘04260’ “Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave” shtesë fondi për objektin “Blerje automjeti për Njësinë e Pyjeve” në shumën 1,248,000 lekë.

b.4- Programin buxhetor ‘05100’ “Menaxhimi i Mbetjeve” për objektin “Blerje dy kamionçina për pastrim mbetjesh” në shumën 3,000,000 lekë.

2. Përdorimi i fondit të kontigjencës në shumën 944,000 lekë për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhet, fond i cili do të përdoret për blerje të automjetit për MZSH, për këtë të kryhen veprimet si më poshtë :

Pakësohet : Gr.00, Prog.04940, Kap.01, Art.609 për shumën 944,000 lekë.

Shtohet : Gr.00, Prog.03280, Kap.01, Art.231 për shumën 944,000 lekë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

